

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të palës ankuese;

B. R. B., vendbanimi, Rr. ... Mali Zi.

E përfaqëson sipas autorzimit, Projekti Ofrimi i ndihmës juridike falas, përkatësisht avokati i autorizuar V. P., në adresë për pranimin e shkresave, zyra Graqanicë, rruga: Cara Dušana, pa nr.,(Qendra tregtare, kati III.)

Kundër;

N/A

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/236/2014 ,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA17538), të datës 30 Prill 2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 21 janar 2021, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B. B. , e regjistruar me numër GSK-KPA-A-012/2018, paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/236/2014, të datës 30 Prill 2018, (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA17538).**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014, i datës 30 Prill 2014, (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA17538).**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 07 Nëntor 2006, B. R. B., (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i ankesës), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), në të cilën thekson se është bashkëpronar, me nënën

e tij Masa dhe motrën S. B., i paluajtshmërisë dhe ate i ngastrave kadastrale me numër ..., ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 03.01.26ha., me kulturë tokë e kultivuar, pyll dhe kullosë, e cila ndodhet në vendin e quajtur, "...", Komuna Kadastrale ..., Komuna Istok, e cila evidentohet në emër të ndërmarrjes, S. Y.-D... .

2. Paraqitësi i ankesës thekson se posedimin mbi pronën e kërkuar e ka humbur më 12 Qershor 1999, për shkak të konfliktit të armatosur të ndodhur në vitet 1998/1999, në Kosovë. Deklaron se në bazë të kontratës për ndërrimin e pasurisë të lidhur në mes të tij dhe anëtarëve të familjes në një anë dhe ndërmarrjes S. Y.-D., ata janë bërë pronarë të pronës lëndore, prandaj kërkon vërtetimin e pronësisë dhe kthimin e paluajtshmërisë në posedim.
3. Në mbështetje të kërkesës i njëjti në AKP, ka dorëzuar dokumentet në vijim;
 - Procesverbalin (fotokopje), lidhur me marrëveshjen për ndërrimin e pronës të dt. 09.04.1996, sipas së cilës i ndërrojnë ngastrat që ishin në emër të tyre me numra ..., ..., ..., ... dhe ..., në sipërfaqe prej 02.42.64ha, me S. Y.-D., në këmbim i fitojnë ngastrat lëndore si në paragraf 1 të këtij aktgjykimi në sipërfaqe prej 02.56.08h , nga S. Y.-D., (AKP-sekretariati konstaton se ky dokument nuk ishte i vërtetuar në gjykatë, andaj edhe nuk është arrit të verifikohet si ekzistues .
 - Procesverbalin në dorëshkrim(fotokopije), i vulosur-protokoluar, me vulë të Y.-D., nr. 01/288, i dt. 10.04.1996, lidhur me përkufizimin dhe marrjen në posedim të paluajtshmërive të ndërruara.
 - Kërkesat-procesverbalet e ushtruesit të ankesës të dt. 27.02.1996 dhe 28.02.1996, sipas së cilave ai kërkon të zbatohet marrëveshja sipas procesverbaleve nga S. Y.-D., (edhe këto dëshmi nuk është arrit të verifikohen nga AKP).
 - Fletën poseduese dhe Kopjen e planit me nr. 105, të dt. 11.04.1996, sipas së cilave ngastrat e kërkuara lëndore nr. ..., ... dhe ..., evidentohen në emër të pronarit, Pasuri Shoqërore -Organit për qeverisje, Kooperativa Bujqësore ..., me 1/1 pjesë ideale.
 - Kopjen e pasaportës në emër të palës ankuese B. B. me nr. ..., të dt. 05.07.1999, lëshuar nga MUP- RCG –CB Bar.
 - Autorizimet e dhëna nga B. M. dhe B. S.a, të dt. 25.02.2008, që pala ankuese ti përfaqësoj në të gjitha organet dhe gjykatat lidhur me pronën lëndore.
4. Më 03 Maj 2007, AKP-ja, ka bërë publikimin e njoftimit të kërkesës për pronën lëndore e cila është gjet tokë e pa shfrytëzuar-kullos dhe e pa uzurpuar. Prona përsëri është notifikuar për mes publikimit me datë 28 Maj 2010, në Gazetën e Njoftimeve nr. 1 dhe në Buletinin e zyrës për

prona të UNHCR-it. Ekipi i notifikimit publikimin e kërkesës e kishte vendosur në vend publik-hyrje dhe dalje të fshatit ..., mandej në zyrën kryesore në UNHCR ,te Ombudspersoni në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Të njëjtat publikime janë vendos po ashtu edhe në Gjykatën Komunale, Kuvendin Komunal, dhe zyrën kadastrale Komunale.

5. Brenda afatit ligjor prej 30 ditë, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, asnjë palë nuk ka shprehur interesim të merr pjesë në procedurë lidhur me pronën që është objekt i kërkesës, kështu që kërkesa e palës ankuese mbetet e pakontestueshme.
6. Sekretaria e AKP-së, gjatë përpunimit të kërkesës dhe verifikimit të dokumentacionit, me datë 05.09.2007, dhe 07.05.2008, gjen se prona lëndore, ngastrat kadastrale me numra, 598/1, ... dhe ..., në kadastër Istog, evidentohen të regjistruara si pasuri shoqërore në emër të Kooperativës Bujqësore ... (Fleta poseduese nr. 105, e dt. 14.08.2007). Gjer sa sipas Certifikatës të Drejtave Pronësore të dt. 10.08.2013, nr. UL-.....9, po ashtu në kadastër Istog, ngastrat kadastrale me numra, ..., ..., ..., dhe ..., zona kad. ..., janë gjetur të regjistruara në emër të B. S.,(R.) dhe B. M. ud. R.. Sipas zyrtarit të kadastrit nuk ishte përmbushur kontrata e ndërrimit të pronës në mes të dy palëve, dhe kontrata e tillë nuk ishte vërtetuar në Gjykatë kompetente në Klinë.
7. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të AKP-së ,të dt. 14.10.2013, prona lëndore nuk është gjetur e regjistruara në emër të palës ankuese apo bashkëpronarëve të tjerë. Sipas Certifikatës të Drejtave Pronësore nr. UL-... të dt. 08.10.2013, të siguruar *ex officio*, nga sekretaria në kadastër Istog , prona e kërkuar lëndore është gjetur në emër të G. D.
8. Me vendimin nr. KPCC/D/A/236/2014, të datës 30 prill 2014, KKPK-ja, e hedhë poshtë kërkesën KPA17538,të palës ankuese B. B., që ka të bëjë me pronën lëndore ngastrat kad. dhe ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 03.01.26ha.,e regjistruar në Fletën poseduese nr. 105, Zona Kadastrale .../... Istog. Në arsyetim të vendimit grupor të KKPK (si në paragrafin 19), i cili i referohet kërkesës lëndore, konkludohet se, pretendimet e palës kërkuese nuk dëshmohen me prova se prona është humbur si pasoj e konfliktit të armatosur të viteve, 1998-99, ndërsa nga dëshmitë e siguruar *ex officio*, prona e kërkuar ishte vendosur nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, (Privatizimit), e cila i është nënshtruar procesit të privatizimit dhe prona i është shitur palëve të treta pas vitit 2005, andaj rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të komisionit.
9. Më 17 nëntor 2014, Vendimi i KKPK-së ishte publikuar-(downladuar), në web faqen elektronike të AKP-së, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se vendimi i ishte dorëzuar

palës ankuese ashtu si parashihet me ligj. Në aktin përcjellës të AKP-së, të datës 18 shtator 2018, të ankesës së palës ankuese në gjykatë supreme theksohet se, kopja e vendimit të KKPK-së me datë 17 nëntor 2014, është publiku në mënyrë elektronike në të web faqe të AKP-së.

10. Pala ankuese B.B. për mes Projektit Ofrimi i ndihmës juridike falas, përkatësisht avokatit të autorizuar V. P., me datë 03 maj 2018, paraqet ankesë kundër vendimit KPCC/D/A/236/2014, të datës 30 prill 2014.

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese vendimin e ankimuar e konteston për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Tutje në ankesë ndër të tjera thekson se i është drejtuar AKP-së për t'iu njohur e drejta e pronësisë në pronën lëndore në bazë të kontratës Br. Ov. ... dt. 19.12.1996, për ndërrimin e tokës të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Istog, me ndërmarrjen Y.-D.”, DP ..., si dhe dokumenteve të tjera, tutje thekson se nuk e kishte bartur pronësinë në kadastrë kompetent për shkak të rrethanave të konfliktit në Kosovë, se KKPK me vendimin e ankimuar ja refuzon kërkesën me arsyetim se, nuk është humbur si pasoj e rrethanave të vitit 1999 në Kosovë, duke i injoruar dokumentet e tij të bashkangjitura kërkesës të vitit 1996, se i ishte mohuar e drejta në pronësi në kundërshtim me nenin 21.1 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat e tjera të Kosovës Ligji nr. 03/L-154., sepse ky ka lidhur punë juridike të vlefshme, etj.
12. Në fund propozon që vendimi i ankimuar të anulohet në pjesën që ka të bëjë me kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që ti njihet e drejta në pronën lëndore ngastrat kad... në sip. prej 01.21.32ha., mandej në ngastrën kad. ... në sip. prej 01.00.29ha., dhe ngastrën kad. 598/2 në sip. prej 00.43.66ha., zona kadastrale dhe të obligohet zyra e kadastrit e Komunës Istok, ta regjistroj pronën e cekur lëndore në libra kadastral në emër të palës ankuese.
13. Ankesës i bashkëngjit dokumentet e njëjta si në pikën 4 të këtij aktgjykimi dhe Kontratën mbi ndërrimin e paluajtshërisë-Tokës, vërtetuar në Gjykatë Komonale Istok OV.br. 3353/96,të dt. 19.12.1996.

Arsyvetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

14. Nga shkresat e lëndës tek dokumentet implementimit faqe 161-162, konstatohet se nga AKP është kontaktar B. B., dhe atij vendimi i është shkarkuar në web faqen AKP-së, me datë 17. 11.

2014. Ai është njoftuar se KPA mund t'ia dërgoi me e-mail, ose me fax, por ai ka shprehë dëshirë që vendimi ti arkivohet në AKP, që ai të mund ta merr personalisht.

15. Gjykata Supreme konsideron se dorëzimit i vendimit të KKPK-së, në këtë mënyrë, nuk mund të pranohet si dorëzim i rregullt ashtu si përcaktohet, sipas nenit 112, të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore,(i zbatueshëm si në kuptim të nenit 12.2 të Rreg.2006/50), ku parashihet se,“*Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuari në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Nëse përmbushën kushtet “komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”.*
16. Po ashtu nuk mund të konkludohet se dorëzimi është bërë edhe si në kuptim të nenit 6.3 në lidhje me nenin 6.5 (b), të Urdhërësës Administrative 2007/5, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079,ku parashihet se: ,“*Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës sigurohet që dërgesa të bëhet në adresën për kryerjen e dërgesave të asaj pale, qoftë duke e dërguar kopjen e dokumentit përmes postës zyrtare, e cila jep vërtetimin, apo përmes dorëzimit personal të kopjes, për të cilin po ashtu merret vërtetimi për dorëzimin e dokumentit. Në rast të dërgimit personal të dokumentit, nëse pala pranuese ka refuzuar pranimin e dokumentit apo nënshkrimin e vërtetimit për praninë, në ditën kur shërbimi është tentuar të kryhet, personi që e dorëzon dokumentin e shënon se dokumenti nuk është pranuar dhe kthehet në Sekretarinë Ekzekutive”.*
17. Nga provat në shkresa të lëndës nuk provohet se Vendimi i KKPK-së, i është dërguar apo në çfarë mënyre ai e ka pranuar, dhe në cilën datë, me që mungon fletëdorëzimi, gjer sa pala ankuese ka ushtruar ankesë me datë 03 maj 2018, ndaj vendimit të KKPK-së. Nga shkaqet e cekura si më lartë, bazuar në dispozitat e lartë cekura, me që dorëzimi nuk provohet se është bërë në mënyrë të rregullt dhe ligjore, kolegji ankesën e palës ankuese e pranon si të lejueshme dhe të afatshme.

Meritat e ankesës

18. Gjykata Supreme pasi vlerësoi dosjen e lëndës, Vendimin e KKPK-së, pretendimet e palës ankuese dhe dëshmive të cilat ia bashkëngjet ankesës të cekura si më lartë, gjen se, ankesa është

e pabazuar dhe vlerëson se KKKPK-ja ka marrë vendim korrekt bazuar në prova dhe ligj me hedhjen poshtë të kërkesës për shkak të mungesës së juridiksionit të saj.

19. Sipas nenit 3.1, të Ligjit nr.03/L-07, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga komisioni për ri-posedim të pronës, nëse ai e dëshmon jo vetëm të drejtën e pronësisë mbi një pronë të pa luajtshme private të kërkuar, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht ti ushtroj ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë, ndërmjet 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999.
20. Pala ankuese në kërkesën e tij, të drejtën në pronën e kërkuar e mbështetë në dokumentet e lartë cekura të paraqitura në AKP dhe tani me ankesë s, kontratën dhe Procesverbalin për ndërrimin e tokës të vitit 1996, sipas së cilave ai dhe bashkëpronaret e tjerë i ndërrojnë ngastrat kadastrale, nr. 23/1, 23/3, 23/4, 24, 25, dhe 26 që ishin në emër të tyre, me Kooperativën Bujqësore Y. D., në këmbim i fitojnë ngastrat lëndore të cekura me kërkesë ,megjithatë sekretariati i AKP këto dokumente, procesverbale dhe marrëveshje të lidhura në mes tyre, nuk kanë mundur ti gjejë në gjykatë, sepse nuk ishin të vërtetuara, prandaj verifikimi i tyre ishte negativ.
21. Sekretaria e AKP-së, gjatë përpunimit të kërkesës së palës ankuese dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur kishte bërë një verifikim negativ të tyre, me datë 05.09.2007, dhe 07.05.2008, sipas raporteve të saj gjen se, prona lëndore ngastrat kad. dhe ..., në Zonën kadastrale ..., në kadastër Istog evidentohen të regjistruara si Pasuri Shoqërore në emër të Kooperativës Bujqësore ..., (Fleta poseduese nr. 105, e dt. 14.08.2007).
22. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të sekretarisë së AKP-së, të dt. 14.10.2013, në Departamentin e Kadastrit në Istok, sipas Certifikatës të Drejtave Pronësore(CDP) e siguruar *ex officio* nr. UL-... të dt. 08.10.2013, prona e kërkuar lëndore është gjetur e regjistruar në emër të G. D., pasi që e njëjta i ishte nënshtruar procesit të privatizimit për mes autoritetit ligjor nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.
23. Në bazë të provave të lartë cekura të cilat i kishte në disponim, KKKPK-ja, dhe me që nuk kishte gjetur as *ex officio* asnjë provë qe e mbështet kërkesën e palës ankuese, me të drejtë konkludon se paraqitësi i kërkesës ka dështuar ta provoi pronësinë apo çfarëdo të drejte tjetër pronësore ndaj pronës së kërkuar, menjëherë para ose gjatë konfliktit të viteve 1998/1999, aq më tepër këtë fakt e pranon edhe vet pala ankuese i cili gjatë komunikimit me sekretarinë e AKP-së, si dhe tani në ankesën e ushtruar ka deklaruar se, prona e kërkuare asnjëherë nuk ishte e regjistruar në libra pronësie në kadastër në emër të tyre.

24. E drejta pronësore mund të fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik (bartjes ligjore), apo trashëgimisë, në përputhje me nenin 20 i Ligjit për Marrëdhënie Themelore Juridike Pronësore” (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr.6/1980),(i zbatueshëm në kohën kur ishte bërë marrëveshja dhe kontrata mbi ndërrimin e pronës së pa luajtshme, në vitin 1996).
25. Megjithatë sipas nenit 33, Ligjit për Marrëdhënie Themelore Juridike Pronësore,” (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr.6/1980), në bazë veprimit juridik (bartjes ligjore), e drejta pronësore ndaj pasurisë së paluajtshme mund të fitohet duke e bërë regjistrimin në regjistrin publik , (libri kadastral), ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme që parashihet me ligj.
26. Edhe ligji aktual në fuqi ,nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore në nenin 36 pika 1 e parasheh se, citim “për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike, dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”, andaj theksimet në ankesë të palës ankuese si më lartë të cilat i bazon edhe në nenin 21.al.1, të këtij ligji, nuk janë të qëndrueshme, sepse sipas këtij neni parashifet fitimi i pronësisë në sendet e luajtshme, e jo në sendet e pa luajtshme si në rastin konkret.
27. Nga të lartë cekurat dëshmohet se marrëveshja dhe kontrata mbi ndërrimin e tokës që tani e ofron me ankesë, asnjëherë nuk ishte zbatuar në departamentin e kadastrit në Istok gjatë periudhës 1996-1999, andaj nga këto fakte rezulton se nuk është fituar e drejta e pronësisë e palës ankuese apo bashkëpronareve tjera, sepse nuk është vepruar si në kuptim të nenit 20 dhe 33, të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike,(G. Zyrt. e RSFJ.,nr.6/80), dhe as në kuptim të nenit 36.1, të ligjit të lartë cekur nr. 03/L-154.
28. Gjykata Supreme konsideron se nuk ka pasur pengesa juridike as praktike që mos të azhurohet në libra kadastral, Kontrata dhe proceset e arritura në mes të palëve ashtu si e thekson pala ankuese duke pasur parasysh se ndërrimi kishte ndodhur në vitin 1996.
29. Bazuar në të gjitha këto që u than më lartë dhe provave në shkresa të lëndës, Gjykata Supreme gjen se, nuk dëshmohet se prona është humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur, por me që ishte e regjistruar si pronë shoqërore e njëjta i ishte nënshtruar procesit të privatizimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit pas vitit 2005.
30. Nga këto fakte vërtetohet se juridiksioni lidhur me pronat shoqërore bie ekskluzivisht në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ashtu si parashihet si në kuptim të nenit 4.1 (c),dhe nenit 5.1 (a),të Rreg. së UNMIK nr.2008/4, e amendamentuar me Ligjin nr.04/L-033, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe ndryshim plotësimet e këtij ligji.

31. Vërtetimi dhe mbrojtja e të drejtave pronësore ndaj pronave shoqërore ,dhe/ose pronave shtetërore nuk është në juridiksionin e KKPK-së, respektivisht kolegjit të apelit të AKP-së.
32. Gjykata Supreme gjen se, KKPK-ja ka nxjerr vendim të drejtë dhe ligjor, në bazë të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë në procedurë të vendosjes. Po ashtu Gjykata Supreme gjen se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim jo të plotë të fakteve, andaj ankesa refuzohet si jo e bazuar.
33. Në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike;

34. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-012-2018, me datë, 21 janar 2021

Bashkp. Profesional,

Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,

Ragip Namani